



# STATUT

I

## SHOQERISE TREGETARE "BALLIU-L" SH.P.K.

Ne Elbasan, sot me date 01.08.2019, unë **Dritan BALLIU** atesia Lytfi i dtl. 07.05.1985 lindur ne Gramsh e banues ne Çekin, Njesia Administrative Pishaj, Gramsh, shtetas shqiptare, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes me nr. BG8081639 e numer personal I50507166F leshuar me date 31.05.2010, ne cilesine e "Ortakut themelues" deklaroj se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, hartoj statutin e shoqerise "BALLIU -L" SH.P.K.

### KREU I

NENI 1  
Krijimi

Shoqëria "BALLIU -L" shpk, është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

NENI 2  
Personaliteti juridik

Shoqeria eshte Person Juridik Privat Shqiptar.

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontribudit te themelueseve te saj ne kapitalin themeltar.

Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj per detyrimet i saj ndaj te treteve.

Ajo nuk pergjigjhet per detyrimet e ortakeve ne vecanti, po per humbjet e shoqerise deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Shoqeria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "BALLIU -A" shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Znj. **Dritan BALLIU**.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.



### **NENI 3**

#### **Selia**

Shoqëria e ka selinë ne adresën: fshatin Çekin, Njesia Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetëm dhe miratimin e organeve kopetente.

### **NENI 4**

#### **Vula e shoqerise**

Shoqeria ka vulen e saj me permbytje "BALLIU -L" sh.p.k

### **NENI 5**

#### **Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Tregti me shumice e pakice, import-eksport mallrash te ndryshme industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiake, materiale ndertimi e hidrosanitare, materiale elektrike, lende drusore, paisje teknologjike e makineri, tregtim automjetesh te gjitha markave e llojeve, pjese kembimi, sherbime te ndryshme servisi, kancelari, etj
- Tregtim lende djegese, vajra lubrifikante, gaz i lengshem, Karburante me pakice, pik karburanti, etj
- Servish makinash, lavazh makinash, parking, etj
- Veprimitari ne fushen e ndertimit te te gjitha llojeve; Projektim e zbatim; Veprimitari sipermanjeje per kerkesa investimesh ne dege e sektore te ndryshem me studime te plota programimi;

Prodhim e tregtim materiale ndertimi, inerte, gure, rere, cakull, mermer, elemetesh te fabrikuara, beton e betonarme, materialesh qeramike-tulla-tjegulla, materiale lidhes gelqere-allci –cimento, materiale me baze bitumi-sintetike; materiale konstruksione metalike, druri, etj

Te gjitha llojet e punimeve te ndertimit, germime dheu, muratur e betoni, rifiniture me materiale te ndryshme , sistemime terrenesh, etj

Ndertime civile, industriale, ekonomike,qendra tregtare ,etj

Ndertim objektesh, ndertesa, rruge, vepra arti, ura, kanalizime, hekurudha, punime e germinate ne toke, punime e sistemime ne toke,

Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile , industriale , veshje fasadash, Restaurim veprash e ndertesash te ndryshme; Punime per prishje objektesh

Ndertime detare, hidraulike e hidroteknike; Vepra te vecanta e punime speciale,

Ndertim rruge, autostrata, tynele , diga e hidroteknike , punime detare, pista aeroportuale, ujesjelles,kanalizime, gazsjelles, vepra kullimi e vaditje, veshje me asfaltbeton te rrugeve, shtrim rrugesh, sistemim dhe asfaltim rrugesh, sheshe, punime, tarracime e sistemime terrenesh, punime te mirembajtjes dhe sinjalistikes ne rruge, bariera, mbrojtje rrugore,etj

Punime carpenterie druri metalike; Impante teknologjike te vecanta ; Punime sherbimi,



- Transportt mallrash e udhetares brenda dhe jashtë vendit, etj
  - Ushtrim aktiviteti per ushqime sociale, bar, Restorante, Hoteleri, Turizem etj
- Si dhe cdo aktivitet tjeter i konsideruar fitimprures dhe ne interes te Shoqerise.

## NENI 6 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore pa afat, me perjashtim te rastit kur Ortaket me Vendim te Asmablese ose Ortaku i Vetem vendosin per nje prishje te parakohshme te saj, ose vendosin per shkurtim apo shtyrije te metejshme.

## KREU II KAPITALI

### NENI 7 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (*njeqind mijë*) lekë. Kapitali i mesiperme eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise **Dritan BALLIU**, dhe perbehet nga 1 (*nje*) pjesë/kuote me vlerë te per gjithshme 100.000 (*njeqind mijë*) lekë, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

### NENI 8 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogelimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

### NENI 9 Kuotat, transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Kuotat e kapitalit janë lirisht te transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaket mund t'u shesin te treteve kuotat e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht, por pasi t'ua kene ofruar per blerje ortakeve brenda shoqerise me kushte jo me pak te favorshme nga ato qe j'u ofrohen te treteve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakeve te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme edhe me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave te te tretet kufizohet me miratim te asamblese se ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

### **KREU III**

#### **NENI 10**

#### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**Organet drejtuese te shoqerise do te jene :**

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve - Ortaku i Vetem - organi me i larte vendim-marres.
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

#### **ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE**

#### **NENI 11**

#### **Organi Vendimmarres**

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

*Ortaku i vetem, vendos për çështje si :*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve

- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## **NENI 12** **Administrimi, Administratori**

Administrator i shoqerise eshte ortaku i vetem i shoqërisë **Dritan BALLIU, Dritan BALLIU** atesia Lytfi i dtl. 07.05.1985 lindur ne Gramsh e banues ne Çekin, Njesia Administrative Pishaj, Gramsh, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. BG8081639 e numer personal I50507166F.

Administratori mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise. Mandati eshte i vlefshem per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

## **NENI 13** **Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpérndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë



- mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Administratori, sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, puneson persona te cileve u cakton detyrat dhe pagen. Shoqeria merr persiper te respekoje rregullat e punesimit ne R.Sh. dhe Sigurimeve Shoqerore.

#### NENI 14 Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:



- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me te kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### **NENI 15 PERFAQSIMI**

E drejta per te perfaqsuar shoqerine para cdo organi shteteror, privat, bankar , gjyqsor , etj ushtrohet nga Administratori i Shoqerise ose nga një person tjeter i autorizuar me prokure nga Administratori.

#### **NENI 16 Thirrja e Asamblese se Pergjithshme dhe Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.



Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **NENI 17 Marrja e vendimeve**

Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

### **NENI 18 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet ne 31 Dhjetor.

### **NENI 19 Bilanci i shoqerise dhe dividentet**

Shoqeria do te realizoje transaksionet e saj financiare nepermjet llogarive rrjedhese qe do te hape ne bankat shqiptare dhe te huaja. Per kapitakin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive dhe shoqeria ka dhe perdon dokumentacionin financiar ne perputhje me dispozitat ne fuqi per kontabilitetin dhe dispozitave te tjera fiskale.

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqerise ndahet ne periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 Dhjetor. Viti ushtrimor do te perkoje me vitin kalendarik.

Shoqeria mban dokumentacionin e nevojshem financiar per administrimin e pasurise dhe per zhvillimin e te gjithe veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e te gjithe legjislacionit perkates ne fuqi.

Bilanci financiar i shoqerise perpilohet ne baze te raportit me shkrim te eksperteve kontabel te autorizuar dhe te raportit te paraqitur nga administratori brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem, shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete, si dhe fondet financiare qe perbejne rezerven e detyrueshme.

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **NENI 20 Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

### **NENI 21**

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondevit ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

### **NENI 22**

*Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## **NENI 23**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

## **NENI 24**

### **Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

## **NENI 25**

### **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

## **NENI 26**

### **Riorganizimi i shoqerise, Bashkimi, ndarja**



Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve-Ortaku i Vetem, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Ligjin Nr. 9901 per tregytaret dhe shoqerite tregtare".

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërise ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

#### **NENI 27**

#### **Ndarja**

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut te Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi.

Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të Ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare pér detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja pér marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe pér palët e treta;
- b) bërjen e aksionarëve/ortakut të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Pér Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

d)

#### **NENI 28**

#### **Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.



**NENI 29**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, administratoret , kapitalin , selin, ortaket, objektin e veprimtarise, sipas vendimit qe do te merret nga Mledhja e Ortakeve-Ortaku i Vetem ne perputhje me kerkesat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoquerite tregtare " . Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoquerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**NENI 30**  
**ZBATIMI I LIGJIT**

Persa nuk eshte shprehur ne kete Akt Themelimi dhe Statut, vlejne dispozitat e Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Shoquerite Tregetare" ; Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" dhe ligjeve te tjera qe lidhen me veprimtarine tregetare ne Republiken e Shqiperise.

**NENI 31**  
**VLEFSHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT**

Shoqeria konsiderohet e riorganizuar dhe krijuar ne perputhje me nenet e ketij Akti – Themelimi e te Statutit bashkelidhur Aktit.

**NENI 32**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**NENI 33**  
**Dispozita përfundimtare**

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe nenshkruehet me vullnetin e tij te lire nga ortaku themelues.

**ORTAKU I VETËM**  
**I SHOQËRISË "BALLIU - L " SH.P.K**  
**Dritan BALLIU**

*Dritan Balliu*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE  
DEGA VENDORE DURRES  
ZYRA NOTERIALE ELBASAN  
NR. 416 REP.



Elbasan dt.01.08.2019

## VERTETIM

Sot ne Elbasan me date 01.08.2019 (nje gusht dymije e nentembedhjete) para meje noteres *Resmie Sh. RUÇI*, anetare e Dhomes Kombetare te Notereve, Dega Vendore Durres e me zyre noteriele ne Elbasan me adresë ne Lagjen "5Maj", prane Gjykates se Rrethit Gjyqosor Elbasan, u paraqit personalisht shtetasi:

**Dritan BALLIU** atesia Lytfi i dtl. 07.05.1985 lindur ne Gramsh e banues ne Çekin, Njesia Administrative Pishaj, Gramsh, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes me nr. BG8081639 e numer personal I50507166F leshuar me date 31.05.2010, i cili deklaroj se dokumentin bashkengjitur –Statut te Shoqerise "**BALLIU - L**" sh.p.k., e nenshkroi me vullnetin e tij te lire para meje noteres.

Une noteria bazuar ne Ligjin Nr. 110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine", e vertetoj dhe e nenshkruaj ate .

## NOTE RE

RESMIE RUÇI